



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

*DRAFT IV  
29 June 2010*

**L I G J**

**Nr \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_**

**PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS**

Në mbështetje të Neneve 78 dhe 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

## **Kreu 1**

### **VLERËSIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS**

#### **SEKSIONI I**

##### **Dispozita Hyrëse**

###### **Neni 1**

###### **Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis nga projekte të propozuara.

###### **Neni 2**

###### **Objekti i ligjit**

Ky ligj përcakton kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve të propozuara private apo publike që mund të shkaktojnë efekte të rëndësishme negative të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta mbi mjedisin në Republikën e Shqipërisë.

###### **Neni 3**

###### **Fusha e zbatimit**

Ky ligj zbatohet për projektet e propozuara private apo publike që mund të shkaktojnë efekte të rëndësishme negative të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta mbi mjedisin, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vend-ndodhjes së tyre.

###### **Neni 4**

###### **Përjashtimet nga fusha e zbatimit e këtij Ligji**

1. Përjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij ligji projektet, për të cilat gjykohet se një proces i tillë mund të bëjë ndesh me qëllimet e mbrojtjes kombëtare.
2. Ministria përgjegjëse për çështjet e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë, krijon Grupin e Përbashkët të Punës, të përbërë nga përfaqësues të të dyja institucioneve për të përcaktuar projektet që janë objekti i këtij paragrafi.
3. Grupi i Përbashkët i Punës miraton rast pas rasti përjashtimin e projekteve objekt i paragrafit 1, pas analizimit të ndikimeve të rëndësishme mjedisore sipas strukturës, madhësisë, shkallës, kapacitetit dhe vendndodhjes së tyre, si dhe sugjeron dhe rekomandon masat e nevojshme për parandalimin apo minimizimin e ndikimeve të tilla të rëndësishme.

## Neni 5

### Përkufizime

Për qëllimet e këtij Ligji, do të përdoren përkufizimet e mëposhtme:

**Projekt** është

1. Ekzekutimi i punimeve të ndërtimit apo instalimeve ose skemave të tjera;
2. Ndërhyrje të tjera në mjedisin dhe peizazhin natyror, përfshirë edhe ndërhyrjet që kanë të bëjnë me nxjerrjen e mineraleve.

**Zhvillues është aplikuesi për leje zhvillimi për një projekt privat ose autoriteti publik që nis një projekt.**

**Publiku** ka kuptimin që i jepet jepet nga ligji për mbrojtjen e mjedisit.

**Publik i ndikuar** nënkupton publikun e ndikuar ose që mund të ndikohet apo që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore, përfshirë edhe OJF mjedisore që shprehin interes.

**Leje zhvillimi** ka kuptimin që i jepet jepet nga ligji nr.10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”.

**Autoritet i Planifikimit** ka kuptimin që i jepet jepet nga ligji nr.10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”.

**Mendimi për Ndikimin e një Projekti në Mjedis (Mendimi)** është dokumenti zyrtar i leshuar nga Ministri si element mbështetës për Autoritetin e Planifikimit në procesin e vendimmarrjes për një Leje Zhvillimi.

**Agencia Rajonale e Mjedisit** është zyra rajonale perkatese e Agjencise së Mjedisit dhe Pyjeve.

**Ditë** ka kuptimin që i jepet jepet nga Kodi i Punes.

**Ministria** është Ministria përgjegjëse për Mjedisin.

**Ministër** është Ministri përgjegjës për Mjedisin.

**Zone Veçanërisht e Mbrojtur** ka kuptimin që jepet në ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar.

## Neni 6

### **Kërkesat e Përgjithshme për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të një Projekti**

1. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mjedisore të zbatimit apo mos zbatimit të projektit.
2. Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projektit.
3. Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin dhe mbylljen e tij, sipas rastit edhe pasojat e mbylljes së aktivitetit dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit si funksionimin normal ashtu edhe mundësinë për aksidente.
4. Vlerësimi i projektit përfshin gjithashtu propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla, ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

## Neni 7

### **Palët në procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis**

Ne procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis marrin pjesë:

- (a) Zhvilluesit e projektit të propozuar;
- (b) Ministria dhe strukturat e saj përgjegjëse;
- (c) Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve;
- (d) Ministrinë e interesuara të linjës;
- (e) Njësitë e Qeverisjes Vendore;
- (f) Publiku.

## Neni 8

### **Informacioni i disponueshem nga autoritetet**

Autoritetet vëne në dispozicion të zhvilluesit, në përputhje me ligjin nr.8053, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit me dokumenta zyrtarë”, dhe me ligjin “Për mbrojtjen e mjedisit”, informacionin që i nevojitet zhvilluesit për përgatitjen e Raportit Paraprak dhe Raportit të Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

## Neni 9

### **Sekreti për ruajtjen e informacionit**

1. Asnjë informacion, që lidhet me çështjet personale apo të biznesit në kuptimin që i jepet atij nga neni 18.1 i ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, nuk bëhet i disponueshem për publikun.

2. Personi qe ka dhene informacionin e nevojshem ne perputhje me kerkesat dhe qellimet e ketij ligji, mund t'i kerkoje Ministrise qe kete informacion apo pjese te tij t'i perjashtoje nga berja publike, me arsyetimin se ky informacion perben sekret tregtar apo industrial per te apo apo per ndonje person tjeter.
3. Kerkesa e paraqitur ne baze te paragrafeve 1 dhe 2 te ketij neni, duhet te permbaje argumentat teknike dhe referencat perkatese ligjore, ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi, ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare", ligjin nr. 8517 date 22.7.1999 "Per mbrojtjen e te dhenave", ligjin nr. 9380, date 28.4.2005 "Per te drejten e autorit dhe te drejtat e lidhura me te" dhe ligjin nr. 9947, date 7.7.2008 "Per pronesine industriale".
4. Ministria, brenda 10 diteve nga marrja e kerkeses, njofton me shkrim personin nese kerkesa e tij per ruajtjen e informacionit ose nje pjese te tij si sekret tregar apo industrial, eshte pranuar apo hedhur poshte.

## **Kreu 2**

### **PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

#### **SEKSIONI II**

##### **Raporti Paraprak i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM)**

#### **Neni 10**

##### **Objekti i Raportit Paraprak**

1. Raporti Paraprak i VNM-se percakton nëse projekti i propozuar referuar ne nenin 10 te ketij ligji, eshte ose jo subjekt i kryerjes se Raportit të Thelluar te Vlerësimit te Ndikimit në Mjedis.
2. Ministri miraton rregulloret perkatese per zbatimin e ketij neni.

#### **Neni 11**

##### **Projektet subjekt i Raportit Paraprak te VNM-se**

Raporti Paraprak për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis kërkohet per:

- (a) Projektet e renditura në Shtojcën II;
- (b) Çdo ndryshim apo shtesë te mundshme ne projektet e renditura në Shtojcën I apo II, te autorizuar, ekzektuar apo ne proces ekzekutimi, dhe qe nuk parashikohet në listën e paraqitur në Shtojcën I, dhe qe mund të shkaktoje efekte te rendesishme negative mbi mjedisin.
- (c) Projektet e renditura në Shtojcën I, qe ndërmerren ekskluzivisht apo kryesisht për zhvillimin dhe testimin e metodave apo produkteve të reja dhe që nuk janë përdorur për më shumë së dy vjet;
- (d) Projektet e renditura ose jo në Shtojcën I ose II, qe nuk kane te bejne drejtpërdrejt apo nuk jane te nevojshëm për administrimin e Zonave Vecanerisht te Mbrojtura, por që vecmas apo ne bashkeveprim me plane dhe projekte të tjera mund te shkaktoje efekte të rendesishme mbi atë

zonë. Në këtë rast, Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshin edhe vlerësimin e ndikimeve të ketyre projekteve në atë zonë duke marrë parasysh edhe objektivat e ruajtjes dhe mbrojtjes së vendit ku do të zbatohet projekti.

## **Neni 12**

### **Procedurat per Raportin Paraprak**

1. Zhvilluesi, pavaresisht nga dispozitat e këtij ligji, mund te kerkoje një mendim paraprak nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve nëse projekti i propozuar përfshihet në fushën e zbatimit të këtij Neni.
2. Zhvilluesi i paraqet Agjencisë të Mjedisit dhe Pyjeve Raportin Paraprak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të shoqëruar me një kopje të kërkesës për Leje Zhvillimi.
3. Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis paraqitet në 15 kopje.
4. Zhvilluesi, pas dorëzimit të dokumentave të lartpërmendura, kryen pagesën e tarifës përkatëse, siç përcaktohet në nenin 44 të këtij ligji.

## **Neni 13**

### **Permbajtja e Raportit Paraprak te VNM-se**

Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përmban emrin e Zhvilluesit, adresën, statusin e tij juridik, projektin e propozuar, si edhe informacionin e mjaftueshëm për të bërë të mundur që Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve të marrë mendimin paraprak të nevojshëm të parashikuar në Nenin 16 dhe Ministria vendimin përkatës të parashikuar në nenin 17.

## **Neni 14**

### **Detyrat e Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve**

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve kryen vlerësimin e të gjitha dokumenteve të dorëzuara nga zhvilluesi brenda 10 ditëve nga paraqitja e Raportit Paraprak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, të shoqëruar me kërkesën për Leje Zhvillimi.
2. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, kur vlerëson se të gjitha dokumentet e paraqitura janë në përputhje të plotë me ligjin dhe është kryer pagesa e tarifës përkatëse, vijon me procesin e shqyrtimit me qëllim marrjen e mendimit paraprak lidhur me nevojën ose jo të përgatitjes së Raportit të Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
3. Nëse brenda 10 ditëve nga data e parashikuar në paragrafin 1, Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve vlerëson që Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis i paraqitur nga zhvilluesi nuk është i mjaftueshëm për të marrë një mendim, ajo i dërgon Zhvilluesit njoftim për të paraqitur informacione shtese. Njoftimi i Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve shoqërohet edhe me arsyet konkrete për nevojën e këtij informacioni.
4. Zhvilluesi siguron informacionin shtese të kërkuar nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve brenda 15 ditëve nga data e njoftimit ose brenda një periudhe më të gjatë kohore, nëse kështu është rënë dakord me shkrim me pare me ARM-në.
5. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve e konsideron të pavlefshëm Raportin Paraprak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis nëse zhvilluesi nuk ia vë në dispozicion informacionin shtese brenda afatit të lartpërmendur. Agjencia njofton me shkrim zhvilluesin në lidhje me këtë vendim.

## **Neni 15**

### **Mendimi i institucioneve të tjera**

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, brenda 5 ditëve nga data e parashikuar në nenin 12.2, i dërgon kopje të Raportit Paraparak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis Njësive të Qeverisjes Vendore, Agjencive të Ujit të Baseneve si edhe institucioneve të tjera, sfera e përgjegjësive mjedisore të të cilave preket nga ky Raport, me qëllim marrjen e mendimeve të tyre.
2. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve i dërgon menjëherë institucioneve të lartpërmendura informacionin shtesë të dërguar nga zhvilluesi, sipas kërkesave të nenit 14.4.
3. Mendimet e autoriteteve të renditura në paragrafin 1 të këtij neni i dërgohen Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve brenda 25 ditëve nga data e referuar në paragrafin 1.
4. Nëse institucionet e lartpërmendura nuk paraqesin mendimet përkatëse pranë Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve brenda periudhës kohore të referuar në paragrafin 3, nenkuptohet se ato janë dakord me Raportin.

## **Neni 16**

### **Mendimi Paraparak i Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve**

Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve brenda 60 ditëve nga data e percaktuar në nenin 14.2 merr mendimin paraparak nëse nevojitet ose jo Raporti i Thelluar i VNM-së, duke u mbështetur në:

- (a) Raportin Paraparak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
- (b) Kriteret përkatëse të përcaktuara në Shtojcën III; dhe
- (c) Mendimet e dhena nga institucionet e referuara në Nenin 15.

## **Neni 17**

### **Vendimi i Ministrisë për Raportin Paraparak të VNM-së**

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve Mjedisit, i dërgon menjëherë Ministrisë dhe institucioneve të referuara në Nenin 15, mendimin paraparak të shoqëruar me arsyetimet përkatëse dhe me të gjithë dokumentacionin e duhur.
2. Ministria vendos nëse nevojitet apo jo një Raport i Thelluar i VNM-së, sic parashikohet në Kreun 3, pasi merr parasysh:
  - (a) Raportin Paraparak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
  - (b) Kriteret e përcaktuara në Shtojcën III;
  - (c) Mendimin paraparak të Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve; dhe
  - (d) Mendimet e dhena nga institucionet e referuara në Nenin 15.
3. Kur Ministria nuk e pranon mendimin paraparak të marrë nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, atëherë ajo jep me shkrim arsyet e këtij mospranimi.
4. Ministria merr vendimin e referuar në paragrafin 2, brenda 10 ditëve nga paraqitja e mendimit paraparak nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve dhe njofton menjëherë me shkrim zhvilluesin për vendimin dhe arsyet e marrjes së tij.
5. Ministria njofton menjëherë me shkrim Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve dhe institucionet e tjera të përmendura në Nenin 15 për vendimin dhe arsyet e marrjes së tij.
6. Ministria regjistron dhe vë në dispozicion të publikut për çdo projekt të shqyrtuar vendimin e marrë lidhur me nevojën ose jo për përgatitjen e Raportit të Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit

në Mjedis, përfshirë vendimin paraprak të Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve dhe arsyet e marrjes së këtij vendimi.

### **SEKSIONI III**

#### **Raporti i Thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis**

##### **Neni 18**

##### **Objekti i Raportit të Thelluar të VNM-se**

1. Raporti i Thelluar i VNM-se paraqet në mënyrë të detajuar identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e të gjitha ndikimeve të drejtpërdrejta apo jo të drejtpërdrejta në mjedis të projektit privat apo publik të propozuar.
2. Ministri miraton rregulloret përkatëse për të përcaktuar përmbajtjen e Raportit të Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, vlerësimin e Raportit të Thelluar të Ndikimit në Mjedis, përfshirë këtu ndikimin direkt dhe indirekt në mjedis.

##### **Neni 19**

##### **Projektet subjekt i Raportit të Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis**

Raporti i Thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis kërkohet për:

- a. Projektet e renditura në Shtojcën I;
- b. Projektet, për të cilat vendimi i Ministrisë në bazë të nenit 17 parashikon që një Raport i tillë është i nevojshëm.

##### **Neni 20**

##### **Procedurat për Raportin e Thelluar të VNM-se**

1. Zhvilluesi, pavarësisht nga dispozitat e këtij ligji, mund t'i kërkojë mendim paraprak Ministrisë në lidhje me përmbajtjen dhe hollësitë e Raportit të Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
2. Ministria, në zbatim të paragrafit 1 të këtij neni, pasi konsultohet me institucionet e përcaktuara në Nenin 15, i pergjigjet zhvilluesit brenda 2 javëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, ose brenda një periudhe më të gjatë kohore, nëse kështu është rënë dakord me parë mes tyre.
3. Ministria, pavarësisht pergjigjes që i ka dhënë zhvilluesit para përgatitjes së raportit, sipas paragrafit 2 të këtij neni, kur e gjykon të nevojshme i kërkon atij të përfshijë në raport edhe informacione shtesë në përputhje me Nenin 22.4 ose 25.

##### **Neni 21**

##### **Përmbajtja e Raportit të Thelluar të VNM-së**

1. Raporti i Thelluar i VNM-së përmban të pakten informacionin e mëposhtëm:



- (a) Emrin e zhvilluesit, statusin juridik dhe adresën e tij, projektin e propozuar dhe vendndodhjen e projektit, si dhe emrin e ekspertit që ka përgatitur Raportin e Thelluar të VNM-së,
  - (b) Përshkrimin e projektit me detajet e vendit ku do të zbatohet, planin dhe madhësinë e projektit, si edhe sipërfaqen e tokës së kërkuar,
  - (c) Përshkrimin e masave që do të merren për shmangien, reduktimin apo, për aq sa është e mundur, përmirësimin e ndikimeve të rëndësishme negative të projektit në mjedis,
  - (d) Të dhënat e kërkuara për identifikimin dhe vlerësimin e efekteve kryesore që projekti mund të ketë në mjedis,
  - (e) Pasqyrë me alternativat kryesore të studiuara nga zhvilluesi përfshirë dhe një përmbledhje të arsyeve kryesore për secilën alternative, duke pasur parasysh efektet mjedisore të tyre,
  - (f) Kur është e mundur, masat zëvendësuese në rast të ndërhyrjeve mëdha në natyrë dhe peizazh, për të cilat kompensimet janë të pamundura,
  - (g) Përmbledhje jo-teknike të Raportit.
2. Raporti i Thelluar i VNM-së përfshin edhe informacionin e specifikuar në Shtojcën IV kur:
- (a) ky informacion ka lidhje me karakteristikat specifike të projektit dhe me tiparet e mjedisit që mund të preken nga ky projekt; dhe
  - (b) Ministria gjykon që zhvilluesi duhet ta sigurojë këtë informacion duke marrë parasysh, në veçanti, njohuritë dhe metodat bashkëkohore të vlerësimit.
3. Raporti i Thelluar i VNM-së evidenton, përshkruan dhe vlerëson, aq sa është e mundur dhe në përputhje me këtë Ligj, efektet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta që projekti i propozuar ka mbi:
- (a) Njerëzit;
  - (b) Florën, faunën, biodiversitetin, zonat vecanerisht të mbrojtura;
  - (c) Tokën, ujin, ajrin, klimën dhe peizazhin;
  - (d) Asetet materiale dhe trashëgiminë kulturore;
  - (e) Bashkeveprimet mes faktorëve të referuar në pikat (a) deri në (d).

## **Neni 22**

### **Paraqitja e Raportit të Thelluar të VNM-së**

1. Zhvilluesi i paraqet Ministrisë Raportin e Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis sikurse parashikohet në nenin 21, së bashku me një kopje të aplikimit për leje zhvillimi, në 15 kopje. Zhvilluesi i paraqet ministrisë në rrugë elektronike kopje Raportin e Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit si dhe Përmbledhjen jo-Teknike të këtij Raporti.
2. Zhvilluesi paguan tarifën përkatëse, siç përcaktohet në nenin 44 të këtij ligji, dhe dorëzon Raportin e Thelluar të VNM-së.
3. Ministria, brenda 10 ditëve nga dorëzimi i Raportit të Thelluar të VNM-së, kryen vlerësimin e të gjitha dokumenteve të dorëzuara nga zhvilluesi.
4. Ministria, kur brenda datës së parashikuar në paragrafin 3, gjykon që Raporti i Thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis i paraqitur nga zhvilluesi nuk është në përputhje me kërkesat e këtij ligji, i dërgon Zhvilluesit në formë të shkruar kërkesën e argumentuar për dokumentacion të mëtejshëm.

5. Zhvilluesi i siguron Ministrise dokumentacionin shtese të kërkuar prej saj brenda 15 ditëve nga data e njoftimit ose brenda një periudhe më të gjatë kohore, nese keshtu është rënë dakord me shkrim me pare me te.
6. Ministria, kur zhvilluesi nuk i vë në dispozicion informacionin shtese brenda afatit të lartpërmendur, e konsideron të pavlefshëm Raportin e Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe njofton me shkrim zhvilluesin në lidhje me këtë vendim.

### **Neni 23**

#### **Mendimi i institucioneve të tjera**

1. Ministria, kur vlerëson se të gjitha dokumentet e paraqitura janë në përputhje të plotë me ligjin dhe pagesa e tarifës perkatese është kryer, vijon me procesin e shqyrtimit me qëllim marrjen e mendimit përkatës në lidhje me Raportin e Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit ne Mjedis.
2. Ministria, brenda 5 diteve i dërgon per mendim një kopje të Raportit të Thelluar të VNM-së, Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve, institucioneve te percaktuara ne Nenin 15, si edhe institucioneve të tjera, sfera e përgjegjësive mjedisore të të cilave preket nga ky Raport, me qëllim marrjen e mendimeve të tyre.
3. Mendimi i Agjencise se Mjedisit dhe Pyjeve dhe institucioneve te tjera te lartpermendura, i paraqiten Ministrisë brenda 30 ditëve nga data e referuar në paragrafin 2 te ketij Neni.
4. Kur institucionet e lartpërmendura nuk i paraqesin mendimet përkatëse Ministrisë brenda periudhës kohore të parashikuar në paragrafin 3 te ketij Neni, nenkuptohet se ato jane dakord me Raportin.

### **Neni 24**

#### **Verifikimi i informacionit nga Agjencia Rajonale e Mjedisit**

1. Agjencia Rajonale e Mjedisit, kur ngarkohet nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, verifikon në vend saktësinë e informacionit të paraqitur në Raportin e Thelluar të VNM-së dhe njofton Ministrinë në lidhje me këtë verifikim.
2. Ministria, kur njoftohet nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve se informacioni i paraqitur në Raportin e Thelluar të VNM-së nuk është i saktë, nuk e pranon Raportin dhe informon Zhvilluesin në lidhje me këtë mospranim.

### **Neni 25**

#### **Informacione shtesë**

1. Ministria, per te pergatitur Mendimin sic kerkohet ne nenin 29, kur e gjykon te nevojshme i kerkon zhvilluesit informacione shtese brenda 30 ditëve nga data e marrjes në dorëzim të Raportit të Thelluar të VNM-së.
2. Kërkesa e Ministrise me argumentat perkatese për informacione shtese i paraqitet zhvilluesit ne forme te shkruar.
3. Zhvilluesi i siguron Ministrisë të gjithë informacionin e kërkuar brenda 25 ditëve nga marrja e kërkesës apo brenda një periudhe më të gjatë kohore, nese keshtu eshte rene dakord me pare me te.
4. Ministria i dërgon institucioneve të përmendura në nenin 23.2 informacionin shtese te paraqitur nga zhvilluesi.

5. Kur zhvilluesi nuk i vë në dispozicion informacionin shtese brenda afatit të lartpërmendur, Ministria, e konsideron të pavlefshëm Raportin e Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe njofton me shkrim zhvilluesin për këtë vendim.
6. Ministria, subjekt i Nenit 9 të këtij ligji, hedh në faqen e saj të internetit kopjen elektronike të Raportit të Thelluar të Ndikimit në Mjedis, përmbledhjen jo- Teknike përkatëse dhe informacionin shtese të dërguar nga zhvilluesi.

### **Kreu 3**

## **INFORMIMI DHE KONSULTIMI ME PUBLIKUN**

### **SEKSIONI IV**

#### **Informimi dhe konsultimi me publikun**

#### **Neni 26**

##### **Informimi i publikut**

1. Zhvilluesi, brenda pesë ditëve nga paraqitja e Raportit të Thelluar të VNM-së në Ministri, publikon një njoftim për projektin e propozuar në të paktën një prej gazetave lokale dhe një prej gazetave kombëtare. Njoftimi publikohet në të paktën dy numra të njepasnjeshëm të gazetës.
2. Njoftimi i referuar në paragrafin 1 përfshin informacionet e mëposhtme:
  - (a) emrin dhe adresën e zhvilluesit;
  - (b) adresën dhe vendndodhjen e veprimtarisë së propozuar;
  - (c) faktin që Ministrisë i është paraqitur një Raport i Thelluar i VNM-së në lidhje me projektin e propozuar;
  - (d) faktin që një kopje e Raportit të Thelluar të VNM-së, planet shoqëruese të tij dhe çdo informacion tjetër i paraqitur bashkë me Raportin mund të inspektohen nga anëtarët e publikut gjatë orarit zyrtar;
  - (e) faktin që një kopje elektronike e Raportit të Thelluar të VNM-së dhe e përmbledhjes jo-Teknike të Raportit mund të konsultohet në faqen e internetit të Ministrisë;
  - (f) vendin ku mund të kryhet inspektimi i këtyre dokumenteve;
  - (g) afatin e fundit deri kur këto dokumente do të jenë në dispozicion të publikut. Ky afat nuk është më pak se 14 ditë nga data e publikimit të njoftimit;
  - (h) faktin që kopjet e shkruara të Raportit të Thelluar të VNM-së janë të disponueshme përkundrejt një tarife të arsyeshme, si dhe vlerën e kësaj tarife;
  - (i) faktin që çdo person është i lire të bëjë komente për projektin e propozuar apo Raportin e Thelluar të VNM-së, dhe që mund t'ia dërgojë ato me shkrim Ministrisë, në adresën e personit të kontaktit;
  - (j) afatin e fundit deri kur këto komente mund t'i dërgohen Ministrisë; ky afat nuk është më i shkurtër se një muaj pas datës së referuar në pikën (g) më sipër.

## Neni 27

### Publikimi i njoftimeve

1. Zhvilluesi vendos tabela njoftimesh në territorin që pershkruhet ne Raportin e Thelluar te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis. Këto tabela njoftimesh përmbajnë informacionin e specifikuar në Nenin 26.2.
2. Tabelat e njoftimeve të referuara në paragrafin e mësipërm lihen në atë pozicion gjatë gjithë procesit të konsultimit, për jo më pak se shtatë ditë radhazi.
3. Tabelat e njoftimeve, me madhësi, pozicion dhe pamje të tillë sa të mund të lexohen lehtësisht nga kalimtarët pa qenë nevoja që këta të futen në këtë tokë, vendosen në një prej objekteve të territorit te pershkruar ne Raport në mënyrë te tille që të mos lëvizin apo te mos shkëputen.
4. Zhvilluesi dërgon në Ministri:
  - a. Kopje të njoftimeve të publikuara në gazeta, sic parashikohet ne Nenin 26.
  - b. Një shkresë ku konfirmohet që ai ka përmbushur kerkesat e paragrafëve 1-3 te ketij Neni.
5. Ministria e vendos informacionin e referuar në paragrafin 4 te ketij Neni në faqen e saj te internetit.

## Neni 28

### Seancat dëgjimore me publikun

1. Ministria, kur gjykon se projekti ka natyrë të tillë që kërkon një seancë dëgjimore me publikun, ajo njofton zhvilluesin dhe Njesine e Qeverisjes Vendore në lidhje me këtë fakt.
2. Publiku, në seancën dëgjimore, shpreh pikëpamjet e tij për Raportin e Thelluar të VNM-së dhe ndikimet e projektit të propozuar.
3. Seanca dëgjimore me publikun mbahet në një vend të përshtatshëm sa më afër vendndodhjes së projektit të propozuar dhe në çdo rast, në bashkinë ku propozohet te zbatohet të projekti.
4. Ministria, kur projekti i propozuar mendohet se mund të ketë ndikim në më shumë se një bashki, i kërkon zhvilluesit që seancat dëgjimore me publikun të mbahen ne te gjitha bashkite e ndikuara.
5. Ministria, kur projekti i propozuar ka rëndësi kombëtare, i kërkon zhvilluesit që një seancë dëgjimore me publikun të mbahet edhe në Tiranë apo në një vend tjetër të përshtatshëm.
6. Zhvilluesi planifikon dhe rregullon vendin e përshtatshëm, ditën dhe orën e seancës apo seancave dëgjimore me publikun dhe njofton për këtë Njesine e Qeverisjes Vendore, Ministrine, si dhe institucionet e tjera përkatëse që kane pergjegjesi te lidhura me fushën e zbatimit të projektit.
7. Zhvilluesi informon publikun për ditën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës apo seancave dëgjimore nepermjet:
  - a. Publikimit te një njoftimi në të paktën një prej gazetave lokale të zonës ku do të zhvillohet projekti i propozuar, dhe një njoftimi në një gazetë kombëtare. Njoftimi publikohet të paktën në dy numra te njepasnjeshem të gazetave.
  - b. Vendosjes se tabelave te njoftimeve në pjesën e territorit te pershkruar nga Raporti i Thelluar i VNM-së.
8. Njoftimi i referuar në paragrafin 7(a) përmban informacionin e mëposhtëm:

- (a) Emrin dhe adresën e zhvilluesit,
  - (b) Adresën dhe vendndodhjen e projektit të propozuar,
  - (c) Faktin që Raporti i Thelluar i VNM-së për projektin e propozuar i është paraqitur Ministrisë,
  - (d) faktin që një kopje elektronike e Raportit të Thelluar të VNM-se dhe të Permbledhjes jo-Teknike të tij mund të konsultohet në faqen e internetit të ministrisë,
  - (e) Faktin që një kopje e Raportit të Thelluar të VNM-së, planet përkatëse dhe çdo informacion tjetër që është dorëzuar bashkë me Raportin, janë të disponueshme për publikun gjatë orarit zyrtar,
  - (f) Vendin ku këto dokumente mund të shqyrtohen,
  - (g) Datën, orën dhe vendin e zhvillimit të seancës dëgjimore me publikun,
  - (h) Faktin që anëtarët e publikut mund t'i shprehin pikëpamjet e tyre gjatë seancës dëgjimore.
9. Seanca dëgjimore me publikun zhvillohet jo më vonë se 15 ditë pas datës së publikimit të njoftimeve në gazeta.
  10. Përfaqësuesi i Njesise se Qeverisjes Vendore drejton seancën dëgjimore me publikun, punimet dhe procedurat e saj.
  11. Përfaqësuesi i Njesise se Qeverisjes Vendore i jep mundësinë çdo personi të pranishëm të shprehë pikëpamjet e tij në lidhje me projektin e propozuar dhe Raportin e Thelluar të VNM-se.
  12. Përfaqësuesi i Njesise se Qeverisjes Vendore, gjatë procesit të seancës dëgjimore me publikun shënon në procesverbalin e takimit të gjitha mendimet, komentet dhe sugjerimet e dhëna në këtë seancë dëgjimore dhe ia dërgon procesverbalin Ministrisë, Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve.
  13. Në rast se zhvilluesi nuk e zhvillon seancën apo seancat dëgjimore me publikun në përputhje me këtë nen brenda tre muajve nga data kur është njoftuar nga Ministria për nevojën e mbajtjes së këtyre seancave, nenkuptohet se ai ka hequr dorë nga kërkesa e tij.
  14. Ministria nuk jep Mendimin për ndikimin në mjedis të projektit të propozuar derisa seanca dëgjimore me publikun të jetë zhvilluar në përputhje të plotë me procedurat e përshkruara në nenet e lartpërmendura dhe me aktet e tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të këtij ligji, si dhe pa marrë procesverbalin përkatës nga Njesia e Qeverisjes Vendore.

## **SEKSIONI V**

### **Mendimi i Ministrit**

#### **Neni 29**

### **Mendimi i Ministrit**

1. Ministri jep Mendimin për projektin e propozuar, duke marrë në konsideratë Raportin e Thelluar të VNM-së si dhe strukturën, fushën e zbatimit, shkallën, madhësinë, kapacitetin, vendndodhjen e projektit të planifikuar si dhe ndikimet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të projektit të propozuar.
2. Ministri, gjatë hartimit të Mendimit, merr në konsideratë të gjitha komentet dhe sugjerimet e bëra nga:

- (a) Institucionet e referuara ne nenin 23.2,
  - (b) Publiku,
  - (c) Publiku gjatë seancave dëgjimore,
  - (d) Një Shtet tjetër, sipas Nenit 34 kur është e përshtatshme.
3. Mendimi i Ministrit eshte i disponueshëm për publikun.

## **Neni 30**

### **Përmbajtja e Mendimit**

1. Ministri, brenda 5 muajve nga data e paraqitjes së Raportit të Thelluar të VNM-së, ose brenda 3 muajve nga data e seancës dëgjimore me publikun kur kjo eshte mbajtur, jep Mendimin me anë të të cilit:
  - (a) Miraton zbatimin e mëtejshëm te projektit pa asnjë vërejtje nga pikëpamja mjedisore;
  - (b) Miraton zbatimin e mëtejshëm të projektit me kushte që duhet të përmbushen nga zhvilluesi; ose
  - (c) Refuzon zbatimin e mëtejshëm të projektit.
2. Në rast refuzimi Mendimi permban edhe arsyet perkatese.
3. Mendimi përfshin:
  - (a) Qendrimin e Ministrise dhe, sipas rastit, kushtet qe duhet të përmbushen nga zhvilluesi;
  - (b) Konfirmimin se Ministri ka marrë në shqyrtim mendimet e shprehura nga publiku dhe institucionet përkatëse si dhe shkallen e reflektimit te tyre;
  - (c) Informacion per procesin e realizuar të konsultimit me publikun;
  - (d) Arsyet dhe konsideratat kryesore ku është mbështetur Mendimi; dhe
  - (e) Përshkrimin, sipas rastit, te masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar dhe nëse është e mundur, për të mënjanuar efektet negative te rendesishme.
4. Ministria njofton menjëherë me shkrim zhvilluesin në lidhje me Mendimin dhe në të njëjtën kohë i dërgon kopje autoriteteve të percaktuara në Nenin 23.2 dhe Autoritetit të Planifikimit.
5. Mendimi regjistrohet dhe publikohet menjëherë.
6. Kur raporti i thelluar i VNM dhe cdo informacion shtese i paraqitur sipas nenit 25 te ketij ligji nuk konsiderohet i mjaftueshem per ministrin per te dhene Opinionin sikurse eshte parashikuar ne paragrafin 1 te ketij neni, atehere ai e rrezon kete Raport. Ministria informon menjehere me shkrim zhvilluesin per rrezimin e Raportit te Thelluar te VNM-se, u dergon kopjet perkatese te vendimit autoriteteve te listuara ne nenin 23.2 te ketij ligji si dhe Autoritetit Perkates te Planifikimit. Vendimi per rrezimin e Raportit te Thelluar te VNM-se regjistrohet dhe publikohet menjehere.

## SEKSIONI VI

### Vendimi i Autoritetit të Planifikimit

#### Neni 31

### Vendimi i Autoritetit të Planifikimit

1. Autoriteti i Planifikimit merr në konsideratë Mendimin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projektit të propozuar kur shqyrton dhenien ose jo të Lejes së Zhvillimit për këtë projekt, apo vendosjen e kushteve për zhvilluesin.
2. Kur projekti i propozuar është subjekt i këtij ligji, asnjë vendim për dhenien ose jo të lejes së zhvillimit për këtë projekt nuk mund të leshohet nga Autoriteti i Planifikimit nëse nuk janë perfunduar të gjitha procedurat e parashikuara nga ky ligj, si më poshtë vijon:
  - a. Në rastin kur kërkohej një Raport Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
    - i. Nëse Ministri nuk jep Vendimin se Raporti i Thelluar i VNM-se nuk kërkohej, ose
    - ii. Nëse Ministri nuk jep Mendimin e tij për Projektin e Propozuar kur ky i fundit me vendim të ministrit është subjekt i kryerjes së Raportit të Thelluar të VNM-se ose
  - b. Në rastin kur kërkohej Raporti i Thelluar i VNM-se për projektin e propozuar, ministri nuk ka dhënë Mendimin e tij për projektin në fjale
3. Në rastin kur Ministri rrezon Raportin e Thelluar të VNM-se për një projekt të propozuar siç parashikohet në nenin 30.5, edhe Autoriteti i Planifikimit, rrezon kërkesën për leje zhvillimi të këtij projekti.
4. Çdo kërkesë për leje zhvillimi që nuk është në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, sikurse dhe çdo leje zhvillimi e perfutur në kundërshtim me po këtë paragraf konsiderohen të pavlefshme..
5. Vendimi apo Mendimi i Ministrit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të projektit të propozuar, është i vlefshëm për atë kohë sa është e vlefshme dhe leja e zhvillimit sikurse parashikuar në nenin 75 të ligjit “Për Planifikimin e Territorit”.

## Neni 32

### Zonat vecanerisht te mbrojtura

1. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe ne rastet kur veprimtaria e propozuar nuk ka te beje drejtpërdrejt apo nuk eshte e nevojshme për administrimin e Zonave Vecanerisht te Mbrojtura, por që vecmas apo ne bashkeveprim me plane dhe projekte të tjera mund te shkaktoje efekte të rëndesishme mbi atë zonë.
2. Kur Mendimi i Ministrise per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis te nje projekti pohon se veprimtaria e propozuar, veçmas apo ne bashkeveprim me veprimtari ose plane dhe projekte të tjera, të realizuara apo të propozuara, mund të ketë ndikim negativ mbi integritetin e nje Zone Vecanerisht te Mbrojtur, atehere Autoriteti i Planifikimit nuk jep Leje Zhvillimi, me perjashtim te rasteve kur:
  - a. nuk ka zgjidhje alternative; dhe
  - b. veprimtaria e propozuar duhet të zbatohet për arsye urgjente të interesave madhore të publikut, përfshirë edhe ato me natyrë shoqërore apo ekonomike; dhe kur
  - c. duhen marrë të gjitha masat kompensuese për të siguruar mbrojtjen e llogjikës së përgjithshme sipas “Natyra 2000”.
3. Arsye urgjente të interesave madhore të publikut që merren në konsideratë, sic parashikohet ne paragrafin 2(b), kur Zona Vecanerisht e Mbrojtur përmban lloje habitatesh natyrore prioritare dhe/ose specie prioritare, janë vetem ato që kanë të bëjnë me shëndetin e njeriut apo sigurinë e publikut ose që sjellin pasoja të rëndësishme pozitive për mjedisin.

## Kreu 4

### VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDISIN NDËRKUFITAR

#### SEKSIONI VII

#### Vlerësimi i Ndikimit në Mjedisin Ndërkufitar

## Neni 33

### Efektet ndërkufitare në Shqipëri

1. Kur Ministria merr informacion apo një Raport VNM-je nga një shtet tjetër në lidhje me një projekt të propozuar që mund të ketë efekte të rëndësishme mbi mjedisin në Shqipëri, ajo fillon menjëherë bisedimet me shtetin në fjalë në lidhje me procedurat dhe kalendarin e paraqitjes se mendimeve për projektin e propozuar.
2. Kur Ministria nuk ka marrë informacion nga shteti tjetër ne lidhje me nje projekt te propozuar qe mund te kete efekte te rëndesishme mbi mjedisin, ajo kërkon:
  - (a) Përshkrimin e projektit së bashku me çdo informacion të disponueshëm në lidhje me efektet e tij të mundshme ndërkufitare;
  - (b) Informacion mbi natyrën e vendimit që mund të merret nga shteti tjetër.
3. Ministria, bazuar ne informacionin e marre sipas paragrafëve 1 dhe 2, dhe në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përkatëse, siç referohet në nenin 23.2 të këtij ligji, vendos nëse dëshiron të marrë pjesë në procesin e VNM-se.



4. Ministria, në rast se vendos të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të VNM-se, i kërkon shtetit tjetër informacionin që referohet në Nenin 21 të këtij Ligji.
5. Ministria, kur merr informacionin e referuar në paragrafin 4, i dërgon menjëherë kopje te këtij informacioni institucioneve të renditura në Nenin 23.2.
6. Per qellime te këtij Neni, zbatohen dispozitat e Kreut 4 të këtij ligji dhe me “zhvilluesi” kuptohet “ministra”.
7. Ministria i dërgon Shtetit tjetër:
  - (a) Mendimet në lidhje me projektin e propozuar;
  - (b) Mendimet e dhena nga institucionet e referuara në paragrafin 5; dhe
  - (c) Mendimet e dhena nga publiku ne zbatim te paragrafit 6.
8. Ministria bën përpjekje për të zhvilluar konsultime me shtetin tjetër, në veçanti, në lidhje me:
  - (a) Efektet e mundshme ndërkufitare të projektit të propozuar,
  - (b) Masat e parashikuara për reduktimin apo eliminimin e efekteve të tilla, dhe
  - (c) Marrëveshjen për një kalendar të arsyeshëm mbi kohëzgjatjen e periudhës së konsultimeve.

## **Neni 34**

### **Ndikimet ndërkufitare mbi një shtet tjetër**

1. Kur, Ministria gjykon se një projekt i propozuar mund të ketë efekte të rëndësishme ne mjedisin e një shteti tjetër, apo kur merr një kërkesë nga një shtet tjetër, ajo i dërgon këtij te fundit:
  - (a) Përshkrimin e projektit të propozuar, së bashku me çdo informacion të disponueshëm per ndikimin e tij të mundshëm ndërkufitar;
  - (b) Informacion mbi llojet e vendimeve që mund të merren nga Ministria.
2. Informacioni i referuar në paragrafin 1 dërgohet sa më shpejt të jetë e mundur dhe, në çdo rast, jo më vonë se data e referuar në nenin 26.2 të këtij ligji.
3. Ministria i jep shtetit tjetër kohë të mjaftueshme për të vendosur nëse ai dëshiron të marrë pjesë në procesin e VNM-se.
4. Ministria, kur shteti tjetër kerkon te marre pjese në procesin e VNM-se, i dërgon atij kopje të Raportit te Thelluar te VNM-se, ne perputhje me nenin 9 te këtij ligji..
5. Ministria, perpara dhenies se Mendimit, sikurse parashikohet ne nenin 29 të këtij ligji, merr parasysh komentet e derguara zyrtarisht nga shteti tjetër.
6. Ministria bën përpjekje për të zhvilluar konsultime me shtetin tjetër, në veçanti, në lidhje me:
  - (a) Efektet e mundshme ndërkufitare të projektit të propozuar, dhe
  - (b) Masat e parashikuara për reduktimin apo eliminimin e efekteve të tilla,
  - (c) Marrëveshjen për një kalendar të arsyeshëm mbi kohëzgjatjen e periudhës së konsultimeve.
7. Ministria i dërgon shtetit tjetër kopje të Mendimit të saj, sipas Nenit 30 të këtij ligji.

## **Kreu 5**

### **NDRYSHIMI I PRONARIT TË VEPRIMTARISË**

#### **SEKSIONI VIII**

##### **Ndryshimi i pronarit të veprimtarisë**

###### **Neni 34**

##### **Ndryshimi i pronarit të veprimtarisë**

1. Në rastet kur zhvilluesi i projektit ndryshon, nenkuptohet se zhvilluesi i ri merr përsipër veprimtarinë dhe detyrimet e zhvilluesit të mëparshëm pa pasur nevojë për procedura të tjera.
2. Në rast se zhvilluesi i projektit ndryshohet para përfundimit të Raportit të VNM-së apo procedurave të VNM-së Paraprake, sipas rastit, të dy zhvilluesit bashkërisht informojnë me shkrim Agjencinë Rajonale të Mjedisit përkatëse dhe Ministrinë në lidhje me ndryshimin e pronësisë duke dhënë edhe hollësitë përkatëse lidhur me zhvilluesin e ri.

## **Kreu 6**

### **EKSPERTËT E VNM-SE**

#### **SEKSIONI IX**

##### **Ekspertët e VNM-se**

###### **Neni 36**

##### **Certifikata për përgatitjen e Raportit të VNM-së**

1. Zhvilluesit, për përgatitjen e Raportit të Thelluar dhe Raportit Paraprak të VNM-së, ngarkojnë subjektet dhe/ose individët e certifikuar nga Ministria si Eksperte të VNM-se dhe Auditimit Mjedisor.
2. Raporti i Thelluar dhe Raporti Paraprak i VNM-së pranohet si i tillë vetëm kur është nënshkruar nga një ekspert i certifikuar. Nënshkrimi nga eksperti i certifikuar nuk i heq zhvilluesit asnjë përgjegjësi apo detyrim në lidhje me atë raport.
3. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen dhe përgjegjësitë e ekspertëve lidhur me raportin, si dhe rregullat dhe procedurat për pajisjen e tyre me certifikatë përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij ligji.

## **Kreu 7**

### **ANKIMIMI**

#### **SEKSIONI X**

##### **Ankimimi**

###### **Neni 37**

###### **Ankimi i zhvilluesit ndaj vendimit te Ministrit per VNM-ne paraprake**

1. Zhvilluesi ankimon ne rruge administrative, sic parashikohet ne Kodin e Procedurave Administrative vendimin e marre nga Ministri ne baze te Nenit 17.4 te ketij ligji, brenda 30 diteve nga publikimi i tij.
2. Zhvilluesi mund te ankimoje vendimin e Ministrit ne rruge gjyqesore, kur parashikohet ne nenin 137 te Kodit te Procedurave Administrative.

###### **Neni 38**

###### **Ankimi i zhvilluesit kunder Mendimit per VNM-ne e Thelluar**

1. Zhvilluesi ankimon ne rruge administrative sic parashikohet ne Kodin e Procedurave Administrative, Mendimin e Ministrit per VNM e Thelluar, brenda 30 diteve nga publikimi i tij.
2. Zhvilluesi mund te ankimoje ne rruge gjyqesore Mendimin e Ministrit per VNM-ne e Thelluar, kur parashikohet ne nenin 137.a te Kodit te Procedurave Administrative.

###### **Neni 39**

###### **Ankimimi i Publikut te Interesuar ndaj Vendimit te Ministrit per VNM-ne paraprake**

1. Publiku i interesuar ankimon ne rruge administrative, sic parashikohet ne Kodin e Procedurave Administrative vendimin e marre nga Ministri ne baze te nenit 17.4 te ketij ligji, brenda 30 diteve nga publikimi i tij.
2. Publiku i interesuar mund te ankimoje vendimin e Ministrit ne rruge gjyqesore, kur parashikohet ne nenin 137 te Kodit te Procedurave Administrative.

###### **Neni 40**

###### **Ankimimi i Publikut te Interesuar ndaj Mendimit te Ministrit per VNM-ne e Thelluar**

1. Publiku i interesuar ankimon ne rruge administrative sic parashikohet ne Kodin e Procedurave Administrative, Mendimin e Ministrit per VNM-ne e Thelluar, brenda 30 diteve nga publikimi i tij.
2. Publiku i interesuar mund te ankimoje ne rruge gjyqesore Mendimin e Ministrit per VNM-ne e thelluar, kur parashikohet ne nenin 137.a te Kodit te Procedurave Administrative.

## **Neni 41**

### **Ankimi nga personi per ruajtjen e informacionit konfidencial**

1. Personi ankimohet ne rruge administrative, sic parashikohet ne Kodin e Procedurave Administrative, kur Ministria e ka hedhur poshte kerkesen e tij bazuar ne nenin 9.3, brenda 30 diteve nga data e publikimit te njoftimit.
2. Zhvilluesi mund te ankimohet ne gjykate kur Ministria ka hedhur poshte kerkesen e tij, bazuar ne nenin 137 te Kodit te Procedures Administrative.

## **Neni 42**

### **Ankimimi i publikut te interesuar per te drejtat te tjera**

Publiku i interesuar ankimon ne rruge administrative kur cmon se i jane shkelur te drejtat e tjera qe i njej ky ligj. Pas perfundimit te ankimit administrativ, publiku i interesuar mund te ankimohet ne gjykate.

## **Kreu 8**

### **SANKSIONET**

#### **SEKSIONI XI**

##### **Sanksionet**

### **Neni 43**

##### **Sanksionet**

1. Kur per qellimet e ketij ligji, zhvilluesi jep informacion fals ose jo te vertete, atehere ndaj tij zbatohen dispozitat e seksionit VIII te Kodit Penal.
2. Kur fillimi i ndertimit pa kompletuar procesin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis perben kundravajtje penale, zbatohen dispozitat e seksionit IV te Kodit Penal. Gjykata vendos qe ndertimi te priset dhe toka te kthehet ne gjendjen e meparshme.
3. Kur fillimi i ndertimit pa kompletuar procesin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis perben kundravajtje administrative, zbatohen dispozitat e ligjit nr.10119, date 23.04.2009 "Per Planifikimin e Territorit" dhe dispozitat e ligjit nr.9780 ,date 16.7.2007 "Per inspektimin e ndertimit".
4. Per rastet e parashikuara ne paragrafin 3 te ketij Neni, Autoriteti i Planifikimit ne zbatim te akteve ligjore ne fuqi urdheron prishjen e cdo ndertimi dhe kthimin e tokes ne gjendjen fillestare.
5. Kur nje person paraqit nje certifikate fallse per ekspert te VNM-se, atehere zbatohen dispozitat e seksionit VIII I Kodit Penal.

## **Kreu 9**

### **DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

#### **SEKSIONI XII**

##### **Dispozitat përfundimtare**

###### **Neni 44**

###### **Tarifat**

1. Zhvilluesi paguan tarifen perkatese, me paraqitjen e Raportit Paraprak të VNM-së ose me paraqitjen e Raportit të Thelluar të VNM-së.
2. Niveli i tarifave percaktohet me Rregullore te Ministrit.

###### **Neni 45**

###### **Agjencite Rajonale te Mjedisit**

Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve kur e shih te arsyeshme, i delegon Agjencive Rajonale te Mjedisit ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi, te drejta per te kryer detyra dhe funksione ne zbatim te ketij ligji.

###### **Neni 46**

###### **Raportimi per zbatueshmerin e ligjit**

1. Ministria publikon raporte vjetore per zbatimin e ketij.
2. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, Autoriteti i Planifikimit te territorit dhe autoritete te tjera respektive i dergojne informacionet perkatese Ministrise me qellim qe t'i mundesojne kesaj te fundit hartimin e Raportit per zbatueshmerine e ligjit.
3. Ministri miraton formatin e duhur per pergatitjen e ketij raporti..
4. Ministria cdo vit i dergon Komisionit European Raportin Vjetor te Zbatimit te ketij ligji.
5. Paragrafi 4 i ketij neni, hyn ne fuqi pas anetaresimit te Republikes se Shqiperise ne Bashkimin European.

###### **Neni 47**

### **Nxjerja e akteve nenligjore**

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit, ngarkohet me nxjerrjen e aktit nenligjor në zbatim të nenit 36.3 të këtij ligji.
2. Ministri ngarkohet me nxjerrjen e akteve nenligjore në zbatim të neneve 4.2, dhe 10, 18.2, 44.2 and 46.3 të këtij ligji.

### **Neni 48**

#### **Zbatimi**

Ministria ngarkohet me zbatimin e këtij ligji.

### **Neni 49**

#### **Vazhdimi i efekteve juridike për aktet nenligjore**

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave numer 1124 datë 30.07.2008 “Për çertifikimin e eksperteve të Vleresimit të Ndikimit në Mjedis dhe të Auditimit Mjedisor” vazhdon të ketë efekte juridike deri në miratimin e Vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave në zbatim të nenit 36.3 të këtij ligji. .

### **Neni 50**

#### **Shfuqizimet**

1. Ligji Nr.8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” shfuqizohet ditën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji.
2. Ligji nr.9700 datë 26.03.2007 “Për Mbrojtjen e Mjedisit nga Ndikimet Nderkufitare” shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.
3. Projektet e propozuara, për të cilat Raportet Paraprake apo të Thelluara të VNM-së janë paraqitur për hyrje në fuqi të këtij Ligji, vlerësohen në përputhje me Ligjin Nr. 8990 dhe nëse është e nevojshme me Ligjin nr. 9700 datë 26.03.2007 “Për Mbrojtjen e Mjedisit nga Ndikimet Nderkufitare”.

### **Neni 51**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

## Shtojca I

### Projektet që janë subjekt i Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

1. Rafineritë e naftes bruto (duke përfshirë ndërmarrjet që prodhojnë vetëm lubrifikantë nga nafta bruto) dhe instalimet për gazifikimin ose lëngëzimin e 500 ton ose më shumë qymyr ose argjila/shiste bitumonoze në ditë.
2.
  - a. Termocentrale ose instalime të tjera me djegie me një prodhim nxehtësie prej 300 ose më shumë megavatësh, dhe
  - b. Stacionet e energjisë berthamore dhe reaktore të tjerë berthamorë duke përfshirë edhe çmontimin ose nxjerrjen e tyre nga përdorimi (me përfshirje të instalimeve kërkimore për prodhimin dhe shndërrimin e materialeve të ndashme (te zberthyeshme) ose të riprodhueshme, fuqia maksimale e të cilave nuk e tejkalon ngarkesën termale të vazhdueshme prej 1 kilovati). Stacionet e Energjisë Berthamore dhe reaktore të tjera berthamore pushojnë se qeni të tilla, kur lenda berthamore dhe elemente të tjera radioaktive të ndotur janë zhvendosur për një kohë të gjatë nga vendi i instalimit.
3.
  - (a) Instalimet për ripërpunimin e lëndës djegëse berthamore të rrezatuara.
  - (b) Instalimet e projektuara për:
    - i. prodhimin ose pasurimin e lëndës djegëse berthamore,
    - ii. për përpunimin e lëndës djegëse të rrezatuara berthamore ose mbetjeve me nivel të lartë radioaktiv,
    - iii. për hedhjen përfundimtare të lëndës djegëse të rrezatuara,
    - iv. vetëm për asgjësimin/depozitimin përfundimtar të mbetjeve radioaktive,
    - v. vetëm për ruajtjen (e planifikuar për më tepër se 10 vjet) të lëndës lëndës djegëse të rrezatuara berthamore ose mbetjeve radioaktive në një vend të ndryshëm nga vendi i prodhimit.
4.
  - (a) Vepra të integruara për shkrirjen fillestare të hekurit të derdhur dhe çelikut;
  - (b) Instalime për prodhimin e metaleve bruto jo-hekur nga xeheroret, koncentratet ose materialet dytësore (material që është nënprodukt) prej proceseve metalurgjike, kimike ose elektrolitike.
5. Instalime për nxjerrjen e asbestit dhe për përpunimin ose transformimin e asbestit dhe produkteve që përmbajnë asbest: për produktet e cimentos me baze asbesti, me një prodhim vjetor prej më tepër se 20,000 ton produkt final, për materiale abrazive me një prodhim vjetor prej më shumë se 50 ton produkt final, dhe për përdorime të tjera të asbestit, me përdorim mbi 200 ton në vit.
6. Instalime të integruara kimike, dmth instalime për prodhimin në shkallë industriale të substancave që përdorin proceset e shndërrimit kimik, ku shumë njësi janë vendosur përballë njëra-tjetres dhe janë të lidhura funksionalisht me njëra-tjetrën për:
  - a. prodhimin e kimikateve bazë organike;
  - b. prodhimin e kimikateve bazë inorganike;
  - c. për prodhimin e plehrave kimikë (te thjeshtë apo te përbërë) me bazë fosfori, azoti, ose potasiumi (fertilizatorë të thjeshtë ose të përbërë);
  - d. për prodhimin e produkteve bazë për mbrojtjen e shëndetit të bimëve dhe biocideve;
  - e. për prodhimin e produkteve farmaceutike bazë duke përdorur një proces kimik ose biologjik;

- f. për prodhimin e eksplozivëve.
7. (a) Ndërtimi i linjave për trafik hekurudhor me distanca të gjata
  - (b) Ndërtimi i aeroportëve me pista që kanë një gjatësi bazë prej 2,100 m ose më tepër. Në kuptim të këtij ligji 'aeroport' nënkupton aeroportet të cilat përputhen me përkufizimin e dhënë në Konventën e Çikagos në 1944, që themeloi Organizatën Ndërkombëtare Civile të Aviacionit (Shtojca 14 e kësaj Konvente).
  - (c) Ndërtimi i autostradave dhe rrugëve ekspres (korsive të autostradave për shpejtesi të lartë). Në kuptimin të këtij ligji, "rruge ekspres" është një rrugë që plotëson kushtet e dhëna në përkufizimin e Marrëveshjes Europiane mbi Arteriet Kryesore të Trafikut Ndërkombëtar, 15 nëntor 1975.
  - (d) Ndërtimi i një rruge të re me katër ose më shumë korsit, ose rregullimi dhe/ose zgjerimi i një rruge ekzistuese që ka dy apo më pak korsit në mënyrë që të bëhet me katër ose më shumë korsit, kur rruga e re ose seksioni i rregulluar dhe/ose i zgjeruar i saj do të jetë 10 kilometra ose më shumë në gjatësi të vazhdueshme.
8. (a) rrugë ujore në brendësi të tokës dhe porte për transportin e brendshëm ujor që lejojnë kalimin e anijeve me mbi 1,350 ton;
  - (b) Portet tregëtare, kalatat për ngarkim-shkarkim të lidhura me tokën dhe portet e jashtme (me përjashtim të kalatave të trageteve) që mund të marrin anije me mbi 1,350 ton.
9. Instalime për asgjësimin e mbetjeve për incinerimin, trajtimin kimik sipas Seksionit D9, ose vend-depozitimet e mbetjeve të rrezikshme, sic përcaktohet në ligjin no ... date ... "Për menaxhimin e mbetjeve"
  10. Instalime për asgjësimin e mbetjeve, për incinerimin, trajtimin kimik sipas Seksionit D9 të mbetjeve jo të rrezikshme me një kapacitet mbi 100 ton në ditë, sikurse përcaktohet në ligjin No ... date ... "Për menaxhimin e mbetjeve".
  11. Nxjerrja e ujit nëntokësor ose skema të rimbushjes artificiale të ujit nëntokësor ku volumi vjetor i ujit të nxjerrë apo të rimbushur është 10 milionë metra kub ose më shumë.
  12. (a) Veprat për transferimin e burimeve ujore midis baseneve lumore kur ky transferim synon në parandalimin e mungesave të mundshme të ujit dhe ku masa e ujit të transferuar e kalon nivelin prej 100 milion metra kub në vit;
  - (b) Në të gjitha rastet e tjera, veprat për transferimin e burimeve ujore midis baseneve lumore kur rrjedha mesatare shumë-vjetore e basenit të nxjerrjes është mbi 2,000 milionë metra kub/në vit dhe ku masa e ujit të transferuar e tejkalon nivelin e 5 % të kësaj rrjedhe.
- Në të dyja rastet, përjashtohen transferimet e tubacioneve të ujit të pijshëm.
13. Impiantet e trajtimit të ujrave të ndotur me kapacitet mbi 150,000 ekuivalent popullsisë sikurse përcaktohet në ligjin no.... date.... "Për Rezervat Ujore"
  14. Nxjerrja e naftës dhe gazit natyror për qëllime tregëtare, ku masa e nxjerrë e tejkalon nivelin prej 500 ton/ditë në rastin e naftës dhe 500,000 m<sup>3</sup>/ditë në rastin e gazit.
  15. Diga dhe instalime të tjera që janë projektuar për të penguar daljen e ujit ose për të depozituar ujin në mënyrë të përhershme, ku një masë e re ose shtesë uji e penguar ose e depozituar është mbi 10 milion m<sup>3</sup>.



16. Tubacionet për transportimin e gazit, naftës ose kimikateve me një diametër prej më shumë se 800 mm dhe një gjatësi prej më shumë se 40 km.
17. Instalime për mbareshtimin intensiv të pulave ose derrave me mbi:
  - (a) 85,000 vende për pulat që rriten për mish, 60,000 vende për pulat që rriten për veze;
  - (b) 3,000 vende për derra për prodhim mish (mbi 30 kilogramë); ose
  - (c) 900 vende për dosa.
18. Impiante industriale për
  - (a) prodhimin e materialeve të buta ose materialeve të ngjashme fibroze;
  - (b) prodhimin e letrës dhe tabelave me një kapacitet prodhues që e tejkalon masën prej 200 tonësh nën ditë.
19. Gurore dhe miniera sipërfaqesore ku sipërfaqja e vendit është mbi 25 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës ku sipërfaqja e vendit është mbi 150 hektarë.
20. Ndërtimi i linjave elektrike në lartësi me një voltazh mbi 220 kV dhe gjatësi mbi 15 kilometrash.
21. Instalimet për depozitimin e naftës, prodhimeve petrokimike ose kimike me një kapacitet prej 200 ose më shumë tonësh.

## Shtojca II

### Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis

1. Bujqësia, silvikultura dhe akuakultura
  - (a) Projekte për ristrukturimin e tokës rurale;
  - (b) Projekte për përdorimin e tokës së pakultivuar ose zonave gjysëm-natyrore për qëllime të bujqësisë intensive;
  - (c) Projekte për menaxhimin e ujit për bujqësi, duke përfshirë dhe vaditjen dhe projektet e kullimit të tokës;
  - (d) pyllëzimi fillestar dhe shpyllëzimi për qëllimet e ndryshimit në një lloj tjetër të përdorimit të tokës;
  - (e) Instalime për rritjen intensive të kafsheve (projektet që nuk përfshihen në Shtojcën I);
  - (f) Rritje intensive e peshkut;
  - (g) Marrje e tokës nga deti.
  
2. Industri nxjerrëse
  - (a) Gurore, miniera sipërfaqësore dhe nxjerrje e torfës (projekte që nuk janë përfshirë në Shtojcën I);
  - (b) Minierat nëntokësore;
  - (c) Nxjerrje e mineraleve nga marina ose llumrat lumore;
  - (d) Shpim i thellë, në veçanti:
    - shpim gjeotermal,
    - shpim për depozitimin e materialeve të mbetjeve berthamore,
    - shpim për furnizim me ujë,me përjashtim të shpimit për studimin e stabilitetit të tokës;
  - (e) Instalime sipërfaqësore industriale për nxjerrjen e qymyrit, naftes, gazit natyror dhe xeheroreve, si dhe të argjilave/shisteve bituminoze.
  
3. Industria e energjisë
  - (a) Instalimet industriale për prodhimin e energjisë elektrike, avullit ose ujit të ngrohtë (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I);
  - (b) Instalime industriale për mbajtjen e gazit, avullit ose ujit të ngrohtë; transmetimin e energjisë elektrike me kablllo në lartësi (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I)
  - (c) Depozita sipërfaqësore të gazit natyror;
  - (d) Depozita nëntokësore të gazeve të djegëshme;
  - (e) Depozita sipërfaqësore të lëndëve djegëse fosile;
  - (f) Briketimi industrial i qymyrit dhe linjtit;
  - (g) Instalime për përpunimin dhe ruajtjen e mbetjeve radioaktive (në rast se nuk janë përfshirë në Shtojcën I);
  - (h) Instalime për prodhimin e energjisë hidro-elektrike;
  - (i) Instalime për përdorimin e fuqisë së erës për prodhim energjie (stacione të energjisë së erës).
  
4. Prodhimi dhe përpunimi i metaleve
  - (a) Instalime për prodhimin e gizes dhe çelikut (shkrirje parësore ose dytësore);
  - (b) Instalime për përpunimin e metaleve prej çeliku:
    - (i) mullinj me rula të nxehte;
    - (ii) farkat me cekicë;
    - (iii) aplikimi i mbulesave mbrojtëse me metal të shkrirë;
  - (c) Fonderite e metaleve hekurore;
  - (d) Instalime për shkrirjen, duke përfshirë aliazhet, të metaleve jo-hekurore, përveç metaleve të çmuara, duke përfshirë produktet e rikuperuara (rafinim, derdhje në fonderi, etj.);

- (e) Instalime për trajtimin sipërfaqesor të metaleve dhe materialeve plastike duke përdorur një proces elektrolitik ose kimik;
  - (f) Prodhimi dhe montimi i mjeteve motorrike dhe prodhimi i motorëve për keto mjete;
  - (g) Kantier ndertimi anijesh;
  - (h) Instalime për ndërtimin dhe riparimin e avionëve;
  - (i) Prodhimi i pajisjeve për hekurudha;
  - (j) Farketim me eksploziv;
  - (k) Instalime për pjekjen dhe aglomerimin e xeheroreve metalore.
5. Industria minerale
- (a) Furrat me qymyr (distilim i qymyrit të thatë);
  - (b) Instalimet për prodhimin e çimentos;
  - (c) Instalime për prodhimin e asbestit dhe prodhimin e produkteve të asbestit (projekte që nuk janë përfshirë në Shtojcën I);
  - (d) Instalime për prodhimin e qelqit, duke përfshirë dhe fibrat e qelqit;
  - (e) Instalimet për shkrirjen e substancave minerale duke përfshirë dhe prodhimin e fibrave minerale;
  - (f) Prodhimi i produkteve qeramike nëpërmjet djegies, në veçanti tjegullat për çati, tullat, tullat zjarr-duruese, pllakat, veshjet prej guri ose porcelani.
6. Industria kimike (Projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I)
- (a) Trajtim i produkteve ndërmjetëse dhe prodhimi i kimikateve;
  - (b) Prodhimi i pesticideve dhe produkteve farmaceutike, bojrave dhe llaqeve, elastomereve dhe peroksideve;
  - (c) Depozitat e produkteve të naftës, petrokimike dhe kimike.
7. Industria ushqimore
- (a) Prodhimi i vajrave dhe yndyrësve vegjetale dhe shtazore;
  - (b) Paketimi dhe ambalazhimi i produkteve shtazore dhe vegjetale;
  - (c) Prodhimi i produkteve bulmet;
  - (d) Prodhimi i birres dhe maltos;
  - (e) Prodhimi i embelsirave dhe i shuruprave;
  - (f) Instalime për therjen e kafshëve;
  - (g) Instalime industriale për prodhimin e niseshtes;
  - (h) Fabrika për prodhimin e ushqimeve me baze peshku dhe vajrave të peshkut;
  - (i) Fabrika sheqeri.
8. Industria tekstile, e lëkurës, drurit dhe letrës
- (a) Fabrika industriale për prodhimin e letrës dhe kartonit (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I);
  - (b) Impiante për para-trajtimin (për operacione të tilla si larje, zbardhje, mercerizim) ose ngjyrosja e fibrave ose tekstileve;
  - (c) Fabrika për rregjime të lëkurave;
  - (d) Instalime për përpunimin dhe prodhimin e celulozes.
9. Industria e gomës
- Prodhimi dhe trajtimi i produkteve me bazë elastometri.
10. Prodhime infrastrukturore
- (a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale;

- (b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qëndrave tregtare dhe parkimet për makinat;
- (c) Ndërtimi i mjediseve të shërbimeve hekurudhore dhe terminaleve të transportit intermodal (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I);
- (d) Ndërtim i fushave ajrore (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I);
- (e) Ndërtim rrugësh, portesh dhe instalimesh për porte, duke përfshirë dhe portet e peshkimit (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I);
- (f) Ndërtime në toke të kanaleve të lundrueshme që nuk përfshihen në Shtojcën I, kanalizime dhe vepra për largimin e ujit të shkaktuar nga përmytjet;
- (g) Diga dhe instalime të tjera të projektuara për të penguar ose për të mbajtur/depozituar ujë në periudha afat-gjata (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I);
- (h) Tramvaj, hekurudha nëntokësore dhe në lartësi, linja të varura/teleferikë ose linja të ngjashme të një lloji të veçantë, të përdorura ekskluzivisht ose kryesisht për transport pasagjerësh;
- (i) Instalime tubacionesh naftë dhe gazi (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I);
- (j) Instalime të kanaleve ujësjetel/akuedoteve në distanca të largëta;
- (k) Veprat bregdetare kundër erosionit dhe punimet në det që mund të ndryshojnë bregun për shkak të ndërtimeve, për shembull të digave, moleve, bankinave të ankorimit dhe punimeve të tjera për mbrojtje nga deti, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe rindërtimin e veprave të tilla;
- (l) Nxjerrja e ujit nëntokësor dhe skemat e tjera për rimbushjen artificiale të ujerave nëntokësore, që nuk janë përfshirë në Shtojcën I;
- (m) Veprat për transferimin e burimeve ujore midis baseneve lumore, që nuk janë përfshirë në Shtojcën I.

#### 11. Projekte të tjera

- (a) Rruget e perhereshme për gara dhe provat e mjeteve motorrike;
- (b) Instalimet për asgjësimin e mbetjeve (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I);
- (c) Impjantet për trajtimin e ujrave të ndotura (projekte që nuk përfshihen në Shtojcën I)
- (d) Vendet për depozitim të llumrave;
- (e) Depot e skrapit të hekurit, përfshirë ato nga automjetet;
- (f) Bankat e provës për motorrat, turbinat ose reaktoret;
- (g) Instalimet për prodhimin e fibrave minerale artificiale;
- (h) Instalimet për rikuperimin ose shkatërrimin e substancave shpërthyes;
- (i) Thertoret

#### 12. Turizmi dhe koha e lirë

- (a) Pistat e skive, teleferiket, ngritesit me kablllo dhe zhvillimet që lidhen me to;
- (b) Vendqendrimet e jahteve dhe anijeve;
- (c) Fshatra turistike dhe komplekse hotelesh jashtë zonave urbane bashkë me zhvillimet që i shoqërojnë ato;
- (d) Vendet për kampe të perhereshme dhe karavane;
- (e) Parqe tematikë.

### **Shtojca III**

#### **Kriteret e përzgjedhjes gjate konsiderimit nese nje vleresim i ndikimit ne mjedis i thelluar eshte i nevojshem**

1. Karakteristikat e projekteve

Karakteristikat e projekteve duhet të merren parasysh duke u përqëndruar në veçanti tek:

- madhësia e projektit,
- efektet kumulative me projekte të tjera,
- përdorimi i burimeve natyrore,
- prodhimi i mbetjeve,
- ndotja dhe bezdite,
- rreziku i aksidenteve, duke pasur parasysh në veçanti substancat apo teknologjitë e përdorura.

2. Vendndodhja e projekteve

Ndjeshmëria mjedisore e zonave gjeografike që mund të preken nga projektet duhet të merret parasysh, duke u përqëndruar kryesisht në:

- përdorimin ekzistues të tokës,
- bollëkun, cilësinë dhe kapacitetin relativ dhe rigjenerues të burimeve natyrore në zonë,
- kapacitetin thithës të mjedisit natyror, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fushave të mëposhtme:
  - (a) ligatinave;
  - (b) zonave bregdetare;
  - (c) zonave malore dhe pyjore;
  - (d) rezervateve dhe parqeve natyrore;
  - (e) zonave vecanerisht të mbrojtura
  - (f) zonat ku janë tejkuluar standardet e cilësisë së mjedisit (të percaktuara në akte të tjera) ;
  - (g) zonat me densitet të lartë të popullsisë;
  - (h) vende me rëndësi historike, kulturore ose arkeologjike.

3. Karakteristikat e ndikimit të mundshëm

Efektet e rëndësishme të mundshme të projekteve duhet të shqyrtohen në lidhje me kriteret e percaktuara në pikat 1 dhe 2 më lart, dhe duke marrë parasysh në menyre të veçante:

- shtrirjen e ndikimit (zonën gjeografike dhe madhësinë e popullsisë së prekur),
- natyrën ndër-kufitare të ndikimit,
- shkallën dhe kompleksitetin e ndikimit,
- mundësinë e ndikimit,
- zgjatjen, frekuencën dhe kthyeshmerinë e ndikimit.

## Shtojca IV

### Informacioni qe duhet perfshire ne raportin e thelluar te vleresimit te ndikimit ne mjedis

1. Përshkrimi i projektit, duke përfshirë në veçanti:
  - një përshkrim të karakteristikave fizike të të gjithë projektit dhe kërkesave për përdorimin e tokës gjatë fazës së ndërtimit dhe zbatimit,
  - një përshkrim të karakteristikave kryesore të proceseve të prodhimit, për shembull, te natyrës dhe cilësisë së materialeve të përdorura,
  - një vlerësim, në bazë të tipit dhe sasise, të mbetjeve dhe shkarkimeve te priteshme (ndotja e ujit, ajrit dhe, tokes, zhurmat, dridhjet, ndricimi, nxehtesia, rrezatimi, etj.) që rezultojnë nga zbatimi i projektit të propozuar.
2. Një përshkrim i alternativave kryesore të studiuara nga zhvilluesi dhe saqarimi i arsyeve kryesore për këtë zgjedhje, duke marrë parasysh efektet mjedisore.
3. Nje pershkrim te aspekteve te mjedisit qe mund te ndikohen ne menyre ndjeshem nga projekti i propozuar, duke përfshirë në veçanti popullsinë, faunën, florën, tokën, ujin, ajrin, faktorët klimatikë, pasurite materiale, duke përfshirë dhe trashëgiminë arkitekturore dhe arkeologjike, panoramën, dhe ndërlihdjen ndërmjet faktorëve të përmendur më lart.
4. Një përshkrim të efekteve të rëndesishme te mundshme të projektit të propozuar mbi mjedisin, qe rezultojne nga:
  - ekzistenca e projektit,
  - përdorimi i burimeve natyrore,
  - shkarkimi i ndotësve, krijimi i bezdive dhe eliminimi i mbetjeve,dhe përshkrimi nga zhvilluesi i metodave parashikuese të përdorura për të vlerësuar efektet ne mjedis. Pershkrimi i ketyre efekteve te rëndesishme te mundeshme te projektit te propozuar duhet te mbuloje efektet e drejtpërdrejta dhe cdo efekt jo të drejtpërdrejtë, dytësor, kumulativ, afatshkurtër, afatmesëm, afatgjatë, te perhershëm, të përkohshëm, pozitiv dhe negativ të projektit.
5. Një përshkrim i masave të parashikuara për të parandaluar, pakesuar ose, aty ku është e mundur, kompensuar te gjitha efektet e rëndesishme negative ne mjedis.
6. Një përmbledhje jo teknike e informacionit të përfshirë në pjesët e mëparëshme.
7. Një pershkrim te vështirësive (mangësive teknike ose te njohurive) qe zhvilluesi ka hasur gjatë hartimit të informacionit të kërkuar.